



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOPSHTIT ZOOLOGJIK
KOMISIONI I PROKURIMIT ME VLERË TË VOGËL

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL
PËR
HARTIMIN E KËRKESAVE TË VEÇANTA PËR KUALIFIKIM
NË PROCEDURËN E PROKURIMIT ME OBJEKT: “MARRJE ME QIRA
MJETESH SPECIFIKE PËR NEVOJA TË INSTITUCIONIT”

Sot, më datë 17.10.2024 në Drejtorinë e Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik mbahet ky procesverbal nga ana e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël (KPVV), i ngritur me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 62, datë 31.01.2024 “Për krijimin e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël”, protokolluar me nr. 95 prot., datë 31.01.2024.

Procesverbali hartohet me qëllim hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: **“Marrje me qira mjeteve specifike për nevojat të institucionit”**, në zbatim të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe konform pikës 11 të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

KPVV-ja vijoi me hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim që do të pasqyrohen në formularin “Ftesa për Ofertë”, duke bërë edhe argumentimin ligjor dhe teknik sipas rastit, si më poshtë:

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (specifikimet teknike të shërbimit):

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	Njësia
1	1 mjet për shërbim me Autovinç Kullë (18-25 m)	orë pune	10
2	1 mjet për shërbim me Autovinç Kullë (32-35 m)	orë pune	10
3	1 mjet për shërbim me Kamion me vinç (Autovinç) (jo më pak se 5 ton)	orë pune	15

Specifikimet teknike të mjeteve:

1. Autovinç Kullë (18-25 m)

- a. Hapja vertikale e krahut në lartësi: minimumi 18-25 m
- b. Hapja horizontale e krahut të vinçit: 7 - 9 m
- c. Pesha mbajtëse e platformës në hapjen e saj maksimale: 125 - 200 kg (2 persona)
- d. Koshi: të jetë rreptësisht i paçmontueshëm
- e. Rotullisja e krahut: 180°+180°

2. Autovinç Kullë (32-35 m)

- a. Hapja vertikale e krahut në lartësi: minimumi 32-35 m
- b. Hapja horizontale e krahut të vinçit: 19-21 m
- c. Pesha mbajtëse e platformës në hapjen e saj maksimale: 280-400 kg (4 persona)
- d. Koshi: të jetë rreptësisht i paçmontueshëm
- e. Rotullisja e krahut: 180°+180°

3. Kamion me vinç (Autovinç) (jo më pak se 5 ton)

Specifikimet teknike vendosen në bazë të nenit të 36, të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 15, pika 3/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

* * *

Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe do të dorëzojë , dokumentet si më poshtë:

1. Ofertën ekonomike të detajuar për çdo zë, me çmimet për njësi dhe në total.

Argumentimi: Ky kriter vendoset konform nenit 29 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira mjetet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Autovinç Kullë (35 m)	1 copë	Pronësi ose me qira
2	Autovinç Kullë (18-25 m)	1 copë	Pronësi ose me qira
3	Kamion me vinç (Autovinç)	1 copë	Pronësi ose me qira

- a) **Aktin e pronësisë së mjetit përkatës:** Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, taksa e mjetit dhe siguracioni i mjetit (i vlefshëm), Raport Inspektimi Konformiteti për pjesën e krahut për ngritje në lartësi nga një subjekt i Akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA).

Ose

- b) **Kontratën e marrjes me qira të mjetit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jetë specifike për objektin që prokurohet dhe afatin e realizimit të kësaj kontrate.
- c) Të gjitha mjetet e lartpërmendura duhet të jenë shoqëruar me fotot përkatëse ku të dallohet qartë targa e mjeteve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 4/ç e nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që shërbimi do të realizohet me mjetet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, të cilat përmbushin specifikimet teknike.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Ky kriter vendoset konform pikës 5 të nenit 82 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

* * *

Afati për hapjen dhe pranimin e ofertave do të jetë më datë 18.10.2024, ora 15:30.

Ky parashikim është në përputhje me pikën 12 të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik me nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor jo më vonë se dita e nesërme e punës nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, me dokumentacionin provues, sipas kërkesave të mësipërme. Në të kundërt, do të bëhet kalimi dhe njoftimi i ofertuesit të radhës i kualifikuar në SPE e kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë.

Ky parashikim është në përputhje me paragrafin e tretë dhe të katërt të pikës 16 të udhëzimit të APP-së me nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar. Afati konsiderohet i mjaftueshëm për të përgatitur dokumentacionin dhe njëkohësisht, bënë të mundur që, në rast mospërmbushje të kriterëve, të mos ketë shumë vonesa për kalimin te operatori ekonomik i radhës.

Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël do të marrë në konsideratë të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës për realizimin e objektit të prokurimit, të renditur nga vendi i parë në vendin e dhjetë, bazuar në paragrafin e katërt, pika 6 e nenit 56 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në pikën 16 të udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor do të marrë në konsideratë për realizimin e këtij objekti vetëm operatorët ekonomikë, oferta e të cilëve nuk është ulur me shumë se 50% e fondit limit të përlogaritur, bazuar në paragrafin e shtatë, pika 6 e nenit 56 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, operatorët ekonomikë kanë të drejtën të ankohen vetëm në autoritetin ose entin kontraktor brenda 2 ditëve nga shpallja e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, bazuar në pikën 1 të nenit 116 “Ankesat për prokurimet me vlerë të vogël”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Afati i realizimit të shërbimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës deri më datë 31 Dhjetor 2024.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Shënim: Operatori ekonomik fitues për nënshkrimin e një kontrate/dorëzimit e faturës tatimore duhet të ketë:

- Kopje të certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave;
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Certifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes sotuerike.

Ky kriter është vendosur konform Njoftimit të Përbashkët midis Drejtorisë së Tatimeve nr. 25366 prot., datë 30.12.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 8480 prot., datë 30.12.2020.

* * *

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Sektori i Pastrimit, Gjelbërimit dhe Mirëmbajtjes, Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve nëpërmjet kërkesës me nr. 490 prot., datë 14.10.2024 me lëndë *“Kërkesë për marrje mjet me qira për nevoja të institucionit”*.

Në përfundim të hartimit të kërkesave të veçanta për kualifikim, KPVV-ja vendos që, pas miratimit të Ftesës për Ofertë nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, të vijojë me hedhjen në Sistemin e Prokurimit Elektronik të procedurës së prokurimit. Ngarkohet për këtë znj. Ilva Ymeraj, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël.

Ky proceverbal hartohet në 2 (dy) kopje, 1 (një) kopje për Dosjen e Prokurimit dhe 1 (një) kopje për Protokollin e Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshtit Zoologjik.

Pasi lexohet, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël.

KOMISIONI I PROKURIMIT ME VLERË TË VOGËL: